

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCES	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5–16

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2025**

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	993,683	113,803
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	877,717	400,000
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	2,605	2,605
Shpenzime të shtyra	7	3,661,230	1,487,081
Total Aktive Afatshkurtra		5,535,235	2,003,489
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	350,899	561,323
Total aktive afatgjata		350,899	561,323
Total aktive		5,886,134	2,564,812
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	9	5,693,218	2,356,097
Detyrime tatimore	10	16,326	18,625
Të tjera detyrime	11	176,590	190,090
Total detyrime afatshkurtra		5,886,134	2,564,812
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata			
Totali i detyrimeve		5,886,134	2,564,812
Kapitali			
Total kapitali aksionar			
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		5,886,134	2,564,812

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performances

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12	13,972,790	14,005,382
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	13	(19,250)	28,898
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(13,443,611)	(13,043,645)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	14	(10,401,499)	(11,230,129)
2) Të tjera shpenzime	15	(3,042,112)	(1,813,516)
Shpenzime të personelit	16	(297,801)	(825,149)
1) Paga dhe shpërblime		(169,986)	(695,769)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(127,815)	(129,380)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(210,424)	(161,431)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	17	(1,753)	(4,519)
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare		49	464
2) Shpenzime të tjera financiare	18	49	464
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		-	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31.12.2025 u firmosën si më poshtë:

Besnik Vellu
Besnik Vellu



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	-	-
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	19,250	13,057
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	210,424	161,431
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(2,651,866)	143,420
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	3,368,822	(612,166)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(47,500)	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	899,130	(294,258)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	899,130	(294,258)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	113,803	421,118
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(19,250)	(13,057)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	993,683	113,803

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "F.SH.S.U." është regjistruar më 21 dhjetor 2017 pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është zhvillimi i aktiviteteve sportive universitare.

Presidenti i Federatës është Z. Besnik Veliu.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L81323451B. Selia qendrore e saj është në Rruga Liman Kaba, Parku Olimpik, Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2025 ishte 1 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK për OJF) dhe ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Euro/LEK	96.77	98.15
USD/ LEK	82.46	94.26

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2025 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Lineare	5%
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Lineare	20%
Mjete Transporti	Lineare	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Lineare	20%
Pajisje informatike	Lineare	25%
Të tjera	Lineare	20%

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2025 është 0%.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në bankë më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Mjete monetare në bankë	993,683	113,803
	993,683	113,803

5. Llogaritë e arkëtueshme tregtare afatshkurtra

Llogaritë e arkëtueshme tregtare aftashkurtra më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Klientë vendas	877,717	400,000
	877,717	400,000

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogaritë të arkëtueshme më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Tatim Fitimi	1,605	1,605
Të arkëtueshme nga Besjan Prekolaj	1,000	1,000
	2,605	2,605

7. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Shpenzime te periudhave te ardhme per materiale konsumi kampionati	-	100,000
Shpenzime te periudhave te ardhme per kancelari	-	24,500
Shpenzime te periudhave te ardhme per promovim aktiviteti	-	255,000
Shpenzime te periudhave te ardhme per uniforma sportive	3,346,230	255,000
Shpenzime te periudhave te ardhme per blerje topash	315,000	240,000
	3,661,230	1,487,081

8. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2025 paraqiten si më poshtë:

	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto				
Gjendja më 31 dhjetor 2023	642,249	444,000	51,000	1,137,249
Shtesa	-			
Gjendja më 31 dhjetor 2024	642,249	444,000	51,000	1,137,249
Shtesa	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	642,249	444,000	51,000	1,137,249
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2023	(294,492)	(107,136)	(12,867)	(414,495)
Amortizimi i vitit	(69,402)	(84,403)	(7,627)	(161,431)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	(363,893)	(191,539)	(20,494)	(575,926)
Amortizimi i vitit	(87,141)	(109,750)	(13,533)	(210,424)
Gjendja më 31 dhjetor 2025	(451,034)	(301,289)	(34,027)	(786,350)
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2023	347,757	336,864	38,133	722,754
Gjendja më 31 dhjetor 2024	278,356	252,461	30,506	561,323
Gjendja më 31 dhjetor 2025	191,215	142,711	16,973	350,899

9. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Furnitorë	5,693,218	2,356,097
	5,693,218	2,356,097

10. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	16,326	15,809
Tatim mbi te ardhurat personale	-	2,816
	16,326	18,625

11. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Pagat e punonjësve	590	48,090
Pagesa per individe me kontrate sherbimi	144,000	110,000
Financime Besnik Velu	32,000	32,000
	176,590	190,090

12. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
Te ardhura nga antaresimi	2,950,000	3,701,908
Te ardhura nga projekte brenda vendit	2,015,000	4,840,000
Te ardhura nga taksa pjesmarrje ne akt nderk	1,127,195	1,079,102
Te ardhura nga sponsorizimi	1,833,916	1,014,318
Te ardhura nga projekte jashte vendit	946,680	170,114
Te ardhura nga granti M. Sportit	4,999,999	3,199,940
Te ardhura konsulence per aktivitete te ndryshme sportive	100,000	
	13,972,790	14,005,382

13. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhura të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(19,250)	(13,057)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	-	41,955
	(19,250)	28,898

14. Shpenzime per aktivitetet kryesore

Shpenzime per aktivitetet kryesore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
Sherbime arbitrimi	480,000	952,500
Sherbime transporti	610,735	997,400
Sherbim qera mbjentesh sportive	474,500	494,000
Sherbim akomodimi per kampionate	1,004,725	1,352,850
Sherbim restoranti per kampionate	47,600	1,524,000
Sherbime mjekesore	100,000	-
Materiale konsumi per kampionatin	1,210,631	506,661
Shpenzime dietash	173,800	-
Shpenzime per uniforma sportive	3,351,097	2,301,919
Shpenzime per pjesmarrje ne aktivitete nderkombetare	1,664,578	2,436,281
Sherbime koordinimi dhe menaxhimi	743,833	289,118
Sherbime performimi dhe kercimi	120,000	-
Shpenzime per blerje topa te ndryshem	420,000	180,000
Shpenzime per blerje materiale sportive		195,400
	10,401,499	11,230,129

15.Të tjera shpenzime

Të tjera shpenzime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024
Karburant	89,882	108,899
Shpenzime per promovimin e aktivitetit	551,390	274,100
Sherbime audio	170,000	60,000
Sherbime Web	19,858	40,000
Sherbim interneti	-	17,920
Shpenzime bankare	84,024	75,842
Taksa dhe tarifa vendore	15,000	15,000
Shpernzime per pritje dhe perfaqesime	780,672	253,970
Sherbime financiare	265,000	194,100
Sherbime ligjore	49,200	85,900
Sherbime administrative	16,730	21,490
Shpenzime per honorare	88,235	-
Kuota antaresimi ne KOKSH	15,000	25,000
Shpenzime udhetimesh	590,856	504,366
Kancelari	24,500	13,400
Sherbime fotografike	61,765	123,529
Sherbime marketingu	120,000	
Sherbim IT	100,000	
	3,042,112	1,813,516

16. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Shpenzime për paga	169,986	695,769
Shpenzime për sigurime shoq e shëndetësore	127,815	129,380
	297,801	825,149

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2025 ishte 1 punonjës.

17. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Gjopa dhe dëmshpërblime	1,753	4,519
	1,753	4,519

18. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fitim nga kembimet valutore financiare	49	464
	49	464

19. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2025 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

20. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.